



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 05.08.2025

Numër Protokolli: 5444/2025

A.nr.1033/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1033/2025, të datës 30.05.2025, të parashtruar nga ankuesi A.I, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Hajzer Salihu nga Prishtina, kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil, në çështjen juridike *“transferim si pasojë e ristrukturimit”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1033/2025, e datës 30.05.2025, të parashtruar nga ankuesi A.I.

A r s y e t i m

Ankuesi A.I (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi*), me datë 30.05.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.AAC/001-2025 të datës 30.04.2025 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale.

Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimit i provave të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me ankesën e ankuesit, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 10.01.2012 mbante pozitën *Drejtori i Departamentit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror* në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Tutje nga shkresat e lëndës rrjedh se Kryeministri i Republikës së Kosovës, ka miratuar Rregulloren (AAC) Nr. 02/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin e Aviacionit Civil. Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datës 09.03.2025 ka nxjerr Vendim me Nr. 228/2025, për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit në Autoritetin e Aviacionit Civil, ndërsa ky i fundit më datë 18.04.2025, ka nxjerr raportin e punës me numër protokolli 859, përmes të cilit ka propozuar që ankuesi të sistemohet në pozitën *Udhëheqës i Divizionit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror*. Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me Vendimin me Nr. AAC/001/2025, të datë 30.04.2025, ka transferuar ankuesin nga pozita aktuale Drejtor i Departamentit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror në pozitën *Udhëheqës i Divizionit të Shërbimeve të Navigacionit Ajrore* në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr.AAC/001-2025 të datës 30.04.2025 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pretendon se ndaj Rregullores (AAC) Nr. 02/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin e Aviacionit Civil, është parashtruar padi fillimisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative e cila tani pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative është deleguar në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ankuesin kërkon që përderisa rregullorja mbi bazë të të cilës është përfunduar procesi i ristrukturimit të shqyrtuar nga gjykata, procedura duhet pezulluar.

Në procedurë të shqyrtimit të ankesës, Këshilli ka pranuar më datë 04.08.2025, njoftimin e Drejtorit të DMZP-së, si organ që ka nxjerr vendimin e kundërshtuar më ankesë, duke njoftuar se më pranimin e Aktgjykimit P.A.nr.07/2025, të Gjykatës Supreme, ka shfuqizuar të gjitha vendimet e ristrukturimit të AAC-së të nxjerra nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me arsyetimin se transferimi i nëpunësve të AAC-së është bërë duke u bazuar në pozitat e përcaktuara sipas Rregullores (AAC) Nr. 01/2025, rregullore kjo e shfuqizuar nga Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit P.A.nr.07/2025. Andaj, mbi bazën e këtyre rrethana, rrjedhimisht duke qenë së akti i kontestuar Vendimi me Nr.AAC/001-2025 i datës 30.04.2025 është shfuqizuar sipas Vendimit me Nr. AAC/025/2025 të datës 04.08.2025 nga Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Kolegji erdhi në përfundim së objekti i ankesës është bërë i pamundur/kotë, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku parashihet: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot, si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1033/2025, të datës 30.05.2025.*

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1033/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Hajzer Salihu;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.